



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës

04.Nr. 67-6139 /14

Kaçanik, 03.03 2014

Në mbështetje të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01.Nr.16-2195/14 për ndarjen e bursave të studentëve të Komunës së Kaçanikut për vitin 2013/2014, si dhe në mbështetje të Rregullores për Ndarjen e Bursave 01 Nr.16-1846/2013, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës , shpall:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR VITIN AKADEMIK 2013-2014

I

Komuna e Kaçanikut ndan bursa për student të rregullt për studime themelore .

Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kushte:

- a) të jetë banorë rezident të Komunës së Kaçanikut;
- b) të jenë student të rregullt, por jo me vet financim;
- c) të ketë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak;
- d) se është student i vitit të dytë e me lartë;
- e) të mos jenë përsëritës të vitit;
- f) e kanë notën mesatare 7, 50 e më të tepër dhe
- g) të jetë student i Universitetit Publik .

II

Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika (I) e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

1. certifikata e provimeve të dhëna së bashku me fotokopjen e indeksit.
2. deklarata e bashkësisë familjare.
3. dëshmia se është invalid i luftës, se është fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, se është person me aftësi të kufizuara dhe se është nga familja në skemën sociale.
4. certifikatën e vendbanimit,
5. certifikatat dhe mirënjohjet, për suksesin e arritur në gara-kurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin arsimor.

Komuna e Kaçanikut, për vitin akademik 2013-2014, do të ndan 40 bursa me nga 50 € në muaj. Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në Zyrën e Pritjes të komunës.

Afati për aplikim është 15 ditë kalendarike, nga dita e shpalljes së këtij konkursi në mjetet e informimit publik.



Drejtori i drejtorisë;
Bajram Kamishi